



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI - CORRUPTION AGENCY



SOVES REPUBLIK E KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. DPK
Nr. Prot. B-prot 03-03/1526/18
Nr. Htaq. 03
Data 30-05-2018
Nr. pages 03
Për SHITJE

DATË/A:	30.05.2018
REFERENC-Ë:	AKK- DPKPP /03-03-1472/18
PËR/ZA/TO:	z. Haxhimet FERATI Menaxher i zyrës së Prokurimit Komuna e Mitrovicës
CC:	z. Agim BAHTIRI Kryetar i Komunës së Mitrovicës
NGA/OD/FROM:	Shaip HAVOLLI Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin me titull: “Projektimi dhe kryerja e punëve në ndërtimin e qendrës së reciklimit industrial për mbeturinat komunale paraprakisht të klasifikuara ose të përziera ne Mitrovicë, me kapacitet deri 10t/h.” me nr. të prokurimit 642/18/3250/511, nr. të brendshëm 642/18/020/511.

I nderuar z. Ferati,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 9 (par. 1, nënpar. 1.5.), 16 (par. 2) dhe 21 (par. 3) të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me tenderin me titull: **“Projektimi dhe kryerja e punëve në ndërtimin e qendrës së reciklimit industrial për mbeturinat komunale paraprakisht të klasifikuara ose të përziera ne Mitrovicë, me kapacitet deri 10t/h”** me nr. të prokurimit 642/18/3250/511, nr. të brendshëm 642/18/020/511, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet kontraktues që t'i ndërmerri të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin me titull: **“Projektimi dhe kryerja e punëve në ndërtimin e qendrës së reciklimit industrial për mbeturinat komunale paraprakisht të klasifikuara ose të përziera ne Mitrovicë, me kapacitet deri 10t/h”** me nr. të prokurimit 642/18/3250/511, nr. të brendshëm 642/18/020/511, në mënyrë që të

respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 04/L -237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092.

Arsy etimi

Agjencia kundër Korrupsionit, me datë 23 maj 2018, ka nxjerrë vendim me numër protokolli: AKK-03-03-1472/18, për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Projektimi dhe kryerja e punëve në ndërtimin e qendrës së reciklimit industrial për mbeturinat komunale paraprakisht të klasifikuara ose të përziera në Mitrovicë, me kapacitet deri 10t/h”** me nr. të prokurimit 642/18/3250/511, nr. të brendshëm 642/18/020/511, i iniciuar nga autoriteti kontraktues Komuna e Mitrovicë.

Agjencia në bazë të dokumenteve të nxjerra nga platforma E-Prokurimi, ka analizuar njoftimin për kontratë, dosjen e tenderit dhe pjesën e specifikimeve teknike, ku ka konstatuar se autoriteti kontraktues, për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë procedurë të hapur, kontratë publike, llojit shërbime, me vlerë të mesme të parashikuar 3,500,000.00€. Agjencia, pasi ka analizuar me kujdes njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, ka vërejtur se autoriteti kontraktues si kriter për dhënie të kontratës ka caktuar kriterin Tenderi ekonomikisht më i favorshëm, ndërsa si nën kriterë i ka caktuar: 1. Çmimi të cilit i ka caktuar koeficientin prej 50%, nën kriteri 2. Oferta teknike 50%, ku janë dhënë poenat si në vijmi: 1 (një) Ing. i Dipl. i Ndërtim-Projekt Menaxher-Poentimi në bazë të përvojes 20; 1 (një) Dipl. I Teknologjisë ose Master- Poentimi në bazë të përvojes 15; 1 (një) Ing. i Dipl. I Makinerisë ose Master- Poentimi në bazë të përvojes 5; 1 (një) Ing. i Dipl. i Hidros.ose Master- Poentimi në bazë të përvojes 4; 1 (një) Ing. i Dipl. i Strukturave ose Master- Poentimi në bazë të përvojes 4; Ing. te Ambientit të licencuar nga MMPH me VNM- Poentimi në bazë të përvojes 4; Metodologjia e punës 20; Plani Dinamik 20; Lista e punëtorëve min 50- Poentimi në bazë të përvojes 4 dhe lista e makinersië 4.

Pas, analizimit të njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit, Agjencia ka vërejtur se nën kriteri Oferta teknike 50%, ku janë dhënë poenat si në vijmi: 1 (një) Ing. i Dipl. i Ndërtim-Projekt Menaxher-Poentimi në bazë të përvojes 20; 1 (një) Dipl. I Teknologjisë ose Master- Poentimi në bazë të përvojes 15; 1 (një) Ing. i Dipl. I Makinerisë ose Master- Poentimi në bazë të përvojes 5; 1 (një) Ing. i Dipl. i Hidros.ose Master- Poentimi në bazë të përvojes 4; 1 (një) Ing. i Dipl. i Strukturave ose Master- Poentimi në bazë të përvojes 4; Ing. te Ambientit të licencuar nga MMPH me VNM- Poentimi në bazë të përvojes 4; Metodologjia e punës 20; Plani Dinamik 20; Lista e punëtorëve min 50- Poentimi në bazë të përvojes 4 dhe lista e makinersië 4. , të specifikuara te kriteret e dhënies-tenderi ekonomikisht më i favorshëm, janë kërkesa të cilat po ashtu janë kërkuara në nenin III.2.4. Kapacitetet teknike dhe porfesionale në dosjen e tenderit dhe ne njoftimin për kontratë.

Agjencia kundër Korrupsionit, konsideron se autoriteti kontraktues me rastin e caktimit të nën kriterit për dhënie të kontratës nr.2. **Oferta teknik**, nuk ka respektuar nenin 52 paragrafi 4 të LPP-së, për arsye se autoriteti kontraktues kriteret e lartë cekuar i ka specifikuar edhe si kërkesa të përzgjedhjes të cilat duhet të plotësohen që një tender të konsiderohet i përgjegjshëm, por edhe si nën kriter për dhënie të kontratës, andaj sipas neni të lartë cekur autoriteti kontraktues duhet të bëjë një dallim të qartë në mes kriterëve të përzgjedhjes në lidhje me aftësitë e përgjithshme profesionale, financiare dhe teknike dhe kriterëve për dhënie të kontratës, dhe nuk ka përsëritje të këtyre dy kategorive të kriterëve.

Agjencia kundër Korrupsionit, rekomandon autoriteti kontraktues që në rast se specifikon në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit kriterin për dhënie të kontratës tenderin ekonomikisht më të favorshëm, duhet të këtë kujdes që të caktoj nën kritere të qarta, precize dhe të cilat janë kritere të matshme.

Agjencia kundër Korrupsionit, konsideron se veprimet e autoritetit kontraktues bien ndesh me nenin 27 Dosja e tenderit, 52 Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës të Ligjit për Prokurim Publik Nr.04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, dhe nenin 28 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik.

Konsiderojmë se shkeljet e tilla nuk duhet lejuar në aktivitete të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsionit rekomandon që të evitohen këto shkelje, përmes njoftimit standard për informata shtesë dhe përmirësimin e gabimeve, duke i njoftuar të gjithë operatorët ekonomik të cilët e kanë tërhequr dosjen e tenderit.

Po ashtu ju njoftojmë se për këto të gjetura do të njoftohet edhe KRPP.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !